

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“KREATIV QERAMIKA” Sh.p.k.**

Ne Tirane, sot me daten 10.09.2022 (dymije e njetete dy) shtetasit:

- 1 **Zj.Kaltrina Deçani**
- 2 **Z. Virtyt Deçani**
- 3 **Zj. Erëmira Deçani**
- 4 **Z.Melos Deçani**

Mblidhen, diskutojne, bien dakort dhe vendosin sa vijon:

**NENI 1**

Formohet shoqeria tregtare **KREATIV QERAMIKA Sh.p.k.**  
Nga Ortake themelues:

- 1.**Zj.Kaltrina Deçani**
- 2.**Z. Virtyt Deçani**
- 3.**Zj. Erëmira Deçani**
- 4.**Z.Melos Deçani**

Emertimi i shoqerise do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

**NENI 2**

Selia e shoqerise do te jete ne adresen:

**Njësia Bashkiake nr. 2, autostrada Tiranë- Elbasan km 2 Godina nr 2 Kodi Postar 1003 Tirane.**

**NENI 3**

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne te gjithe juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashte shtetit.

Me vendim te ortakeve, mund të krijohen ose anulohen seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukturore te shoqerise si dege apo perfaqesi edhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

**NENI 4**

Kapitali i shoqerise

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë, është **12.000,000** (Dymbedhjet milion) lekë i ndarë në 4 kuota.

**Neni 8 – Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre**

8.1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë zotërohen nga ortakët si më poshtë:

- Zj. Kaltrina Deçani**, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 6.120,000 lekë ose 51% të kapitalit  
**Z. Virtyt Deçani**, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 2.040,000 lekë ose 17% të kapitalit  
**Zj. Erëmira Deçani**, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 1.920,000 lekë ose 16% të kapitalit  
**Z. Melos Deçani**, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 1.920,000 lekë ose 16% të kapitalit

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve. Ortaket mund te shesin kuotat e tyre personave te trete ne perputhje me dispozitat e legjislacionit te aplikuar dhe parshikimeve te statutit te kesaj Shoqerie.

Transferimi i Kuotave në rrugë trashëgimie bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe pergjithesisht siç parashihet ne ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve. Në rastet e bashkëpronësisë veprohet ne zbatim te legjislacionit ne fuqi.

Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise dhe me investime personale te ortakeve konform miratimit paraprak te asamblese se ortakeve..

Ortaket kane te drejta pronesia mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge te ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

#### NENI 5

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte me nje afat te pacaktuar.

#### NENI 6

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi , ne perputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

#### NENI 7

Shoqeria çel llogari bankare ne monedhe shqiptare si edhe çdo lloj valute, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shtetore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortaket e Shoqerise ose Administratori i emeruar prej tyre, depozitojne faksimilet e firmave të tyre orgjinale ne Bankat ku eshte çelur llogaria bankare.

#### NENI 8

Ortaket, kane të drejte të transferojne jashte territorit të Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre perfshire dhe fondet dhe kontributet e pjeseve të kapitalit themelor, Transferimete duhet të jene të vertetuara me Akt Noterial dhe per nje gje të tille duhet të marre paraprakisht vendim me shkrim Asambleja e Ortakeve.

Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sapo tu behen të ditura.

#### NENI 9

Shoqeria krijohet per të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit qe do te jete :

Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të pajisjeve hidrosanitare dhe te qeramikes.

Ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën të bëjë ndryshime në objektin e veprimtarisë së shoqërisë sa herë ata i duket e nevojshme.

#### NENI 10

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, shoqëria mund të zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtimit të tjera të cilat janë me interes për mbarvajtjen e shoqërise.

#### NENI 11

Me vendim të Asamblese se ortakeve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

#### NENI 12

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërise dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i njej asamblese se ortakeve që janë krijuar me ortakeri. Ortaket mund t'ia delegojnë kompetencat një ose me shumë administratoreve të caktuar prej tyre ose dhe një personi fizik jashtë ortakerise se shoqërise, vetëm mbi bazën e prokures.

#### NENI 13

Administrator i shoqërise **KREATIV QERAMIKA Sh.p.k.** është:  
Duke filluar nga data e miratimit të këtij statuti, administratorët e shoqërisë "**KREATIV QERAMIKA**" shpk për një periudhë 5-vjeçare do të jenë  
Znj. **Kaltrina Deçani**, madhore, lindur Pejë, Kosovë.

Administratori i shoqërise gëzon të gjitha të drejtat që ligji « Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » parashihet, pa asnjë kufizim të kompetencave.  
Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese se Përgjithshme të Ortakeve.

#### NENI 14

Ky akt themelimi u redaktua në 5 ekzemplare, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike dhe është i vlefshëm kur nënshkruhet nga ortaket themelues

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE**  
**KALTRINA DEÇANI**  
**KALTRINA DEÇANI**

**ERËMIRA DEÇANI**

**VIRTYT DEÇANI**  
**VIRTYT DEÇANI**

**MELOS DEÇANI**  
**MELOS DEÇANI**

**Shemira Deçani**  
Tiranë, më 10.09.2022